



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.551/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Afrim Tejecit, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prizren, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 31.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e Afrim Tejecit, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prizren, nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, me numër ZL.Anr.551/2017 e datës 30.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i me datën 30.10.2017 ka pranuar një ankesë nga Afrim Tejeci, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prizren, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se në shkollat “Mustafa Bakija”, “Gjon Buzuku”, “Kurill”, “Remzi Ademi” si dhe në shkollën “Arbanë” në Prizren ka pasur parregullsi në numërimin e votave brenda subjektit të njëjtë politik, pasi që sipas parashtruesit të ankesës, atij i mungojnë votat e familjarëve të cilët kanë votuar në këto shkolla.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit Afrim Tejeci, nuk e paragjykon çështjen

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.551/2017 me datën 31.10. 2017.



Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala

A handwritten signature in blue ink, appearing to be "H. Shala", written over the printed name.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*